

Në përgjigje suajës, Nr. 358 prot., datë 25.08.2022, hyrë në AKBN në rrugë elektronike me lëndë “Kërkesë për informacion” ju informojmë si më poshtë:

1. A është zbatuar ligji i cili ngarkon këto dy subjekte të bëjnë pyllëzimin dhe rehabilitimin e zonës minerare. Nëse po, sa është sipërfaqja e gjelbëruar? Në territorin e fshatit “Zvezdë”, Bashkia Maliq, Qarku Korçë, ushtrojnë aktivitet minerar shfrytëzimi dy subjekte minerare të cilët janë në kufi me njëri-tjetrin.

- Subjekti “FAVINA” sh.p.k. është i pajisur me lejen minerare të shfrytëzimit Nr.653/3, datë 15.11.2001 dhe lejen minerare Nr.1039/1, datë 04.07.2007, dhënë për shfrytëzimin e mineralit gur gëlqeror në objektin “Zvezdë”, Bashkia Maliq, Qarku Korçë. Sipas projektit fillestar të shfrytëzimit të miratuar në Këshillin Teknik dhe planeve vjetore të miratuar pranë A.K.B.N-së, subjekti shfrytëzon mineralin e gurit gëlqeror dhe në përfundim të aktivitetit minerar, kryen rehabilitimin e sipërfaqes së prekur nga shfrytëzimi (detyra të lëna edhe në mbikëqyrjen e kryer nga grupi i specialistëve ). Në këto kushte, nuk mund të bëhet rehabilitimi i sipërfaqes së shfrytëzuar, pasi subjekti është në aktivitet minerar në zhvillim e sipër.

- Subjekti “MILENIUM” sh.p.k. është i pajisur me leje minerare shfrytëzimi Nr.581/1, datë 13.11.2000, dhënë për shfrytëzimin e mineralit gur gëlqeror, në objektin “Zvezdë”, Bashkia Maliq, Qarku Korçë. Ky subjekt është ngjitur me subjektin “Favina” sh.p.k dhe zhvillon aktivitet minerar në zbatim të projektit fillestar të shfrytëzimit dhe planeve vjetore të miratuar pranë A.K.B.N së. Kariera është në zhvillim dhe nuk kanë përfunduar shkallët e sipërme që të fillojë rehabilitimi.

2. A janë ngritur grupe kontrolli për inspektim të këtyre subjekteve, çfarë është konstatuar?

Në zbatim të Ligjit Nr 10304 datë 15.07.2010, i ndryshuar, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, neni 43, subjektet janë mbikëqyrur vazhdimisht dhe për këtë janë hartuar raportet gjashtë mujore dhe vjetore të mbikëqyrjes, ku përshkruhen kontrollet dhe detyrat e lëna për secilin subjekt. Raportet gjashtë mujore dhe vjetore dërgohen në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë. Subjektet minerare kanë paguar garancinë financiare për rehabilitimin e mjedisit si dhe taksat vendore për çdo vit, të cilët kontrollohen nga ana jonë në miratimet e planeve vjetore. Këto subjekte minerare, në impiantet e thyerjes-fraksionimit të mineralit të gurit gëlqeror, kanë instaluar sistemin me ujë për eliminimin e pluhrave gjatë punës. Nga grupi i mbikëqyrjes, në datën 14.06.2022, subjekteve u është lënë detyrë të përfundojnë shkallët e sipërme të karrierës dhe të fillojnë rehabilitimin.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin, mbetemi të gatshëm për bashkëpunimin